



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	09.09.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Faredin SYLEJMANI Menaxher i Zyrës së Prokurimit - Spitali Rajonal Gjilan
CC:	z. Abdylatif LATIFI U.D. i Drejtorit Ekzekutiv - Spitali Rajonal Gjilan
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	<i>net</i> z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull " Furnizim me pajisje mjekësore Lot 1 Central monitoring system with patient monitor, Lot 2 Harmonik skallper dhe Lot 3 CTG, EKG dhe Sterilizatorë "

I nderuari z. Sylejmani ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin me titull " Furnizim me pajisje mjekësore " Lot 1 Central monitoring system with patient monitor, Lot 2 Harmonik skallper dhe Lot 3 CTG, EKG dhe Sterilizatorë me numër prokurimi: 702-14-52-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me pajisje mjekësore " Lot 1 Central monitoring system with patient monitor, Lot 2 Harmonik skallper dhe Lot 3 CTG, EKG dhe Sterilizatorë me numër prokurimi: 702-14-52-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-I/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Zyra e Prokurimit në Spitalin Rajonal Gjilan ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " *Furnizim me pajisje mjekësore Lot 1 Central monitoring system with patient monitor, Lot 2 Harmonik skullper dhe Lot 3 CTG, EKG dhe Sterilizatorë* " me numër prokurimi: 702-14-52-121, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë: 18.07.2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.07.08.2014 dhe me dt.08.08.2014 ka paraqitur kërkesë zyrtare pranë Autoritetit kontraktues përmes së cilës ka kërkuar që ti ofrohet dokumentacioni i nevojshëm për këtë procedurë të prokurimit. Agjencia, pasi ka ekzaminuar dhe shqyrtuar me kujdes dokumentet e tenderit ka evidentuar gjetjet si në vijim:

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë procedurë të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka vërejtur se në Planifikimin e Prokurimit për vitin 2014, Autoriteti kontraktues e ka paraparë aktivitetin e prokurimit në fjalë, por nuk e ka paraparë vlerën e parashikuar për këtë kontratë veprim ky i cili bie ndesh me Ligjin në fuqi për prokurimin publik.

Gjatë krahasimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me rubrikën kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, Agjencia vëren se kriteret e përzgjedhjes të kjo rubrikë të cilat janë caktuar nuk janë identike, çka paraqet mospërputhje në mes njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Në pikën 7 të kësaj rubrike në njoftimin për kontratë autoriteti kontraktues ka kërkuar garancion për pajisjen e ofruar së paku 1 vit, ndërsa në dosjen e tenderit ka kërkuar 2 vite garancion. Në dosjen e tenderit është kërkuar dëshmi për mbulim me pjesë rezervë së paku 5 vite nga data e skadimit të afatit garantues, ndërsa e njëjta kërkesë nuk është vendosur edhe në njoftimin për kontratë.

Mospërputhja e tillë në mes njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit mund të krijojë paqartësi tek tenderuesit, Autoriteti kontraktues duhet që gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit ti kushtoj rëndësi dhe të kujdeset çdo herë që njoftimi për kontratë të jetë në pajtim me dosjen e tenderit.

Në Dosjen e Tenderit dhe Kërkesën e njësisë kërkuese, që ka përgatitur A.K. për këtë aktivitet të prokurimit, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme, **Agjencia ka vërejtur se specifikimet teknike që janë përpiluar për lot 1 ku është kërkuar Furnizim me sistemin qendror me monitorim**, autoriteti kontraktues ka përshkruar specifikime teknike të cilat janë favorizuese për një prodhues dhe në të njëjtën kohë specifikimet e tilla i eliminojnë disa prodhues të këtyre pajisjeve mjekësore.

Autoriteti kontraktues ka përshkruar disa specifikime si në vijim: Display size: 10.4 inch, color TFT type LCD, waveform display color: 12 colors, NIBP (systolic, diastolic, MAP), SpO2, pulse rate,

temperature, Numeric display color: 12 colors, Alarm items: Upper/lower limit alarms, arrhythmia alarms, technical alarms, connector disconnection alarm, noise alarm, electrode off alarm, waveform, detecting alarm, probe off alarm, cuff/hose check alarm, sensor check alarm, low, battery alarm), Leads: 3-electrode cable: I, II, III; 6-electrode cable: I, II, III, aVR, aVL, aVF, 2 from V1 to V6, Heart rate averaging: Calculated by using the most recent 4 or 12 beats, Heart rate alarm: Upper limit range: 16 to 300 beats/min, OFF in 1 beat/min steps, Lower limit range: OFF, 15 to 299 beats/min in 1 beat/min steps, Alarm items: TACHYCARDIA, BRADYCARDIA, Arrhythmia message: asystole, vf, vt, ext tachy, ext brady, sv, freq, tachy, vpc run, v, brady, tachycardia, bradycardia, pause, couplet, early, vpc, multiform, v rhythm, bigeminy, rigeminy, vpc, vpc, irregular rr, prolonged rr, no pacer pulse, pacer, noncapture. Respiration rate counting range: 0 to 150 counts/min Alarm: Upper limit range: 2 to 150 counts/min in 2 counts/min steps, OFF, Apnea alarm: Setting range: OFF, 5 to 40 s in 5 s steps, Displayed message: APNEA, SpO2 display: Display update cycle: Every 3 s or when alarm is generated, Measuring method: Two wavelength light absorption method, Data delay time: ≤ 10 s, Display range: 0 to 100%SpO2, Declared range: 70 to 100%SpO2, Non Invasive Blood Pressure, NIBP, Measuring method: Oscillometric, Measuring range: 0 to 300 mmHg, Accuracy: ± 3 mmHg ($0 \text{ mmHg} \leq \text{NIBP} \leq 300 \text{ mmHg}$), Measurement mode: Manual, STAT (≤ 15 min), Periodic, PÉTT and SIM, Display items: Systolic (SYS), diastolic (DIA), mean (MAP), cuff pressure during NIBP measurement, pulse rate, Safety Maximum pressurization value cuff inflation limiter: Adult/Child: 300 to 330 mmHg Neonate: 150 to 165 mmHg, Measuring range: -50 to 300 mmHg, Measuring accuracy: ± 1 mmHg ± 1 digit ($-50 \text{ mmHg} \leq \text{IBP} < 100 \text{ mmHg} \pm 1\% \pm 1$ digit ($100 \text{ mmHg} \leq \text{IBP} \leq 300 \text{ mmHg}$), Temperature: Thermistor probe Measuring range: 0 to 45°C, Measuring accuracy: $\pm 0.1^\circ\text{C}$ ($25^\circ\text{C} \leq \text{TEMP} \leq 45^\circ\text{C}$) Recording method: Thermal array recording, Number of channels: 3 (maximum) Paper speed: 12.5, 25, 50 mm/s, Battery operation time: 3 hours, DC voltage: aprox. 9.6 V etj.

Specifikimet teknike që duhet ti kenë këto pajisje janë specifikuar nga Autoriteti kontraktues në atë mënyrë që i përshtatën vetëm prodhuesit **NIHON KOHDEN** modelit **VISMO** dhe eliminonjë prodhuesit tjerë të këtyre pajisjeve. Lidhur me Specifikimet teknike për 3 Lotet AKK vëren se Autoriteti kontraktues ka caktuar minimumin dhe maksimumin e specifikave, sipas LPP-së **Autoriteti kontraktues më konkretisht Njësia Kërkuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos jenë me vlera fikse por të caktohet minimum i kërkesave teknike dhe që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet me pajisje të tilla mjekësore**

Agjencia sipas detyrës zyrtare me dt.08.08.2014 ka kërkuar tërë dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, pasi Autoriteti kontraktues ta këtë përfunduar procesin e vlerësimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues e ka ofruar në Agjenci dokumentacionin e kërkuar me dt.01.09.2014.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka ekzaminuar dhe krahasuar me kujdes të gjitha dokumentet e këtij tenderi ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Për këtë kontratë dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 23 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar vetëm 6 OE.

Agjencia vëren se autoriteti kontraktues këtë aktivitet të prokurimit e ka ndarë në **3 lote** (pjesë), për **lot 1** ofertat i kanë dorëzuar **5 Operator ekonomik**, ku sipas Komisionit vlerësues **3 oferta** kanë qenë të përgjegjshme, për **lot 2** ofertat i kanë dorëzuar **2 OE** të cilat sipas Komisionit vlerësues

janë të përgjegjshme, kurse për lot 3 ka pasur 4 oferta të cilat sipas K. Vlerësues janë që të gjitha të përgjegjshme.

Për lot 1 nga Operatorët ekonomik janë ofruar këto çmime si në vijim:

Duke u bazuar në Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderëve Operatori ekonomik nr. 1 ka ofruar çmimin prej **18721.00 €**, OE nr.2 ka ofruar çmimin prej **29355.00**, Operatori nr.3 ka ofruar çmimin **5680.00 €**, OE nr. 4 ka ofruar çmimin prej **5600.00 €** dhe Operatori ekonomik nr.5 ka ofruar çmimin prej **6312.00 €**. Gjatë ekzaminimit të ofertave për lot 1 Agjencia konstaton se Operatori ekonomik i cili është propozuar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat në dosjen e tenderit tek rubrika kërkesat mbi aftësinë teknike dhe profesionale ku është kërkuar lidhur me pikën 3. **Qertifikata për serviseret të trajnuar nga prodhuesi me nivel profesional për pajisjet qe ofertoni (lot 1 dhe lot 2)** Fituesi i këtij loti i rekomanduar nga Komisioni vlerësues nuk ka ofruar dëshmi se posedon Qertifikata për serviser të trajnuar nga prodhuesi, si dhe në pjesën e rubrikës së njëjtë pika 7 dhe 8 ku është kërkuar garancion **dëshmi për mbulim me pjesë rezervë se paku 5 vite nga data e skadimit të afatit garantues. Garancioni për pajisjen e ofruar me se paku 2 vite** lidhur me këtë kërkesë Operatori ekonomik ka ofruar një deklaratë mbi garancion por e njëjta nuk është e nënshkruar dhe e vulosur e që konsiderojmë se nuk është përmbushur kjo kërkesë.

Duke u bazuar në procesverbalin e hapjes së tenderëve dhe raportin e vlerësimit të tenderëve për lot 2 kanë qenë gjithsej 2 oferta të cilat sipas Komisionit vlerësues janë të përgjegjshme dhe janë ofruar këto çmime: Operatori i renditur në numrin 1 ka ofruar çmimin prej **34500.00 €**, ndërsa Operatori i dytë ekonomik ka ofruar çmimin prej **58320.00 €**.

Komisioni vlerësues pasi ka vlerësuar ofertat për lot 2 ka rekomanduar që kontrata ti jepet Operatorit i cili është renditur me nr. 1 në raportin e vlerësimit të tenderëve. Agjencia pasi ka ekzaminuar dhe krahasuar ofertat për këtë lot ka konstatuar se OE i cili është propozuar për dhënie të kontratës nga ana e Komisionit vlerësues, sipas AKK-së nuk është i përgjegjshëm, pasi që nuk ka përmbushur kërkesën lidhur me rubrikën Kapaciteti teknik ose profesional pika 1 ku është kërkuar *autorizimi origjinal nga prodhuesi me te dhënat e tenderit i vulosur dhe i nënshkruar nga prodhuesi për titullin e tenderit (apo Lotit)*. OE i propozuar për dhënie të kontratës ka ofruar Autorizimin nga prodhuesi vetëm të nënshkruar e jo të vulosur ashtu, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu konstaton se Operatori ekonomik i cili është propozuar për dhënie të kontratës për lot 3 nuk është i përgjegjshëm, pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat në dosjen e tenderit tek rubrika kërkesat mbi aftësinë teknike dhe profesionale ku është kërkuar lidhur me pikën 7 dhe 8 në pjesën e rubrikës së njëjtë është kërkuar garancion **dëshmi për mbulim me pjese rezervë se paku 5 vite nga data e skadimit te afatit garantues. Garancioni për pajisjen e ofruar me se paku 2 vite** lidhur me këtë kërkesë Operatori ekonomik ka ofruar një deklaratë mbi garancion por e njëjta nuk është e nënshkruar dhe e vulosur dhe si e tillë nuk mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur edhe disa shkelje tjera lidhur me lot 1 njëri nga Operatorët ekonomik është eliminuar me arsyetimin se nuk e ka të kompletuar çertifikatën ISO, sipas Komisionit vlerësues Operatori ka ofruar çertifikatë ISO me Tûv dhe si e tillë nuk mund të pranohet sipas Komisionit dhe Deklaratës CE i mungon konformiteti, ndërsa për lot 3 ku janë kërkuar të njëjtat certifikata, Komisioni vlerësues Operatorin e njëjtë e ka shpallur si të përgjegjshëm. Duhet theksuar se Komisioni vlerësues i Autoritetit kontraktues ka pasur raste që ka pranuar edhe certifikata ISO me Tûv për disa Operator tjerë ekonomik. Lidhur me këtë lot Komisioni vlerësues e ka shpallur si të përgjegjshëm OE i cili ka qenë i renditur ne numrin 2, pas ekzaminimit të ofertës së këtij Operatori, AKK ka vërejtur se në formularin e dorëzimit të tenderit tek pjesa e validitetit të tenderit OE nuk e ka plotësuar numrin e ditëve për te treguar se sa është valid tenderi, sipas LPP-së ky OE konsiderohet sikur të mos tenderonte fare, andaj do duhej që të shpallej si i papërgjegjshëm nga ana e Komisionit vlerësues.

Duhet theksuar se të gjitha rekomandimet e Komisionit vlerësues lidhur me këtë procedurë të prokurimit janë miratuar edhe nga Zyrtari Kryesor i Prokurimit i Autoritetit kontraktues.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 8 Planifikimi i Prokurimit, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike dhe nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !